

“ERTI 2”LLC

RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
SHFRYTËZIMIN, THËRRMIMIN DHE SEPERIMIN E
GURIT GËLQEROR NË VENDBURIMIN NË PRELLOVC
KK. SKENDERAJ

Dhjetor -2025

Kompania “*ERTI 2*”*LLC* Skenderaj, për kryerjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror dhe gurëthyesin me seperacion për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në lokalitetin Prellovc , zona kadastrale Prellovc , komuna e Skenderajs, autorizon Sami Heten me nr. te licences9/16, e vlefshme prej 19.06.2020 deri me 19.06.2025:

Investitori: Erti 2 LLC

Pronar : Florim Bucolli

Hartuar nga përsone i Licencuar

Sami Heta_____

+38344170911

samibheta@hotmail.com

Raporti i Vlerësimit të ndikimit në Mjedis

Përmbajtja:

1. HYRJE	5
1.1 HISTORIKU I SHKURTË I KOMPANISË	5
a) Vendndodhja e Projektit.....	6
b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	9
c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	10
d) Përlogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së ndërtimit dhe operimit	12
2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	22
3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME	25
4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	26
4.1 Karakteristikat Hidrografike	28
4.2 Ndryshimet natyrore	28
5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	29
5.1 Ndikimet në ajër	29
5.2 Ndikimet në tokë	29
5.3 Ndikimet në ujë	29
5.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	30
5.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	30
5.6 Ndikimet nga zhurma	30
5.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	30
6. Trashëgimia Kulturore	31
7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	32
9. PERSHKRIMI I MASAVE	33
9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	34
9.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	34
9.3 Masat për mbrojtje nga zhurma	36
9.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	38
9.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	38

9.10 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

.....37

9.11 Menaxhimi i mbeturinave39

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE39

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI40

12. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME45

13. LITERATURA E PERDORUR46

Lista

1. Hyrje

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe aktivitetëve tjera minerare është punuar në bazë të kërkesës së Florim Bucolli drejtor i bordit të kompanisë “ERTI 2” LLC Luboshdë komuna e Skenderajut, për të aplikuar për Pëlqim Mjedisor, i cili është një dokument i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për marrjen e lejes për eksploatim të gurit gëlqeror në lokalitetin Prellovc komuna e Skenderaj.

Në raport do të analizohen ndikimet në mjedis të tërë proceseve teknologjike për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe aktivitetëve tjera minerare, duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të ushtrohet kjo veprimtari dhe rreth tij. Duke analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe aktivitetëve tjera minerare, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inzhinjeroko- teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, behet hartimi i raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin eksploatim i gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare dhe mjedis. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së realizimit të procesit teknologjik për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare, dhe pas përfundimit të projektit, për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare në lokalitetin e lartcekur.

1.1 HISTORIKU I SHKURTË I KOMPANISË

Aktiviteti mineral i shfrytëzimit dhe perpunimit të gurit gëlqeror në lokacionin e quajtur „MALI I FSHATIT ” në Prelloc komuna e Skenderajut është duke u zhvilluar tash e 20 vite në zonën e licencës së kompanisë “Erti 2 ” LLC me seli në Prellovc ..


Kompania “Erti 2 ” LLC posedon licencë të shfrytëzimit në këtë lokacion me një sipërfaqe 5 ha nga Komisioni i Pavarur i Minerave dhe Mineraleve në Prishtinë. Numri i kësaj licence është 2287/KPMM/22 me afat deri më 10.10.2029. Mirpo meqenese kompania merret me këtë

veprimtari menjëhe pas perfundimit te luftes se fundit ne Kosovë dhe ka pasur suksese mjaft te medha mendon qe te zgjeroi aktivitetin minerar edhe jashtë komunës se SkenderajUT fushen aktuale te shfrytezimit në Prellonc Komuna e Skenderaj ne menyre qe te siguroi rezerva te mjaftueshme per prodhimin e materialeve ndertimore te fraksioneve te ndryshme.

Shkalla e tanishme e shfrytezimit te gurit gëlqeror ne Kosovë ka arritur nivelin me shtetet e regjionit me një tendencë gjithnjë ne rritje te kërkesave për këto materiale ndërtimore, përdorimi i tyre ka gjetur një game të gjer te aplikimit ne industrinë e ndërtimit si dhe ne infrastrukturën e rrugëve. Andaj kjo gurore do te vazhdoi te zbut nevojat e tregut për ketë agregat (tampon)ne ketë trevë e ne veçanti të kerkesave te ndryshme te kompanive te cilat janë aktualisht duke punaur ne nderim të rrugëve. Duke parë nevojën dhe benifitet të shfrytezimit të gëlqerorit, paraqitet nevoja që të hartohet projekti Gjeologjik dhe ai i shfrytezimit per zgjerim te fushes aktuale.

a) Vendndodhja e Projektit


Lokacioni ku do të bëhet eksploatimi i gurit gelqeror gjendet ne anën e djathtë të rrugës Prellonc - Polac në një largesi mbi 2.3 km nga rruga magjistrale Skenderaj – Mitrovicë, konkretisht lokacioni gjendet në vendin e quajtur „Deli”. Shfrytezimi seperimi dhe perpunimi i gurit gëlqeror dhe kryerja e aktiviteve tjera minerare ku është planifikuar të bëhet zgjerimi i fushës ekspluate e që kompanija ka licencë në pjesët e ngastrave kadastrale nr. **P-72015058-00313-0** dhe **P-72015058-00314-1** , **P-72015058-00314-2** Çertifikatën nr. 48287/25 dt 10.11.2025 zona kadastrale Prellonc , komuna Skenderaj , pronë e blerë nga kompanija “Erti 2”LLC Skenderaj me pronar Florim Bucollin m e sip 70,470 .00 m2.



VB”Mali i fshatit “ PRELLOVC KK SKENDERAJ

Kopanja ka pëlqimin komunal dhe nga Agjensioni pyjor i Kosovës për ushtrimin e veprimaris. VB ndodhet ne një lokacion ku ne afersi te kompleksit nuk gjenden objekte te banimit,objektet e banimit me te aferta gjenden ne largesi mbi 800m. Objektet e tjera te banimit ndodhen ne largesi me te madhe.

Në vijim po e paraqesim pjesën e hartës topografike ku shihet lokacioni i kompanisë: “ERTI 2 ” LLC Skenderaj, Eksploatim termim I gurit gëlqeror.



Ky Vendburimi i gëlqerorit shtrihet në koordinatat dhe koordinatat per qasje ne rrugë
Koordinatat gjnden ne shtoiçë



Ne aspektin morfologjik, regjioni përbëhet nga pjesë me relief të lartë mbi 900m si varg malet e Grykes se Prellonc . Relievi në përgjithësi është më tepër kodrinor-malore dhe i përcillur me shumë pak sipërfaqe të rrafshëta dhe me tokë bujqësore. Këtu popullata më tepër merret me bujqesi kurse një pjesë e popullatës merret edhe me blegtori. Lidhjet me komunikacionin rrugor janë mjaftë të mira ,vendburimi lidhet me rrugën e asfaltuar Skenderaj-Prellonc -Vushtrri dhe pastaj me të gjitha pjesët e Kosovës.

Popullata dhe Vendbanimet

Komuna e Skënderajt zë vend qendror në Drenicë, shtrihet në një sipërfaqe prej 378 km². Në veri kufizohet me Komunën e Mitrovicës, në lindje me Vushtrrin, në jugëperëndim me Drenasin (Gllgovcin) dhe Klinën, ndërsa në përendim me Burimin (Istogun). Nëpër Komunë kalojnë rrugë të rëndësishme automobilistike të cilat e lidhin me qendrat e tjera të Kosovës. Kjo komunë shtrihet rreth koordinantav gjeografike: 42° 44 48 V dhe 20° 47 19 L.

Territori i Komunës së Skenderajt ka konfiguracion kodrinoro-malorë me lartësi mbidetare mesatare prej 500–700 m, kurse pikën më të lartë e paraqet maja e Qyqavicës me lartësi 1 117 m.

Ka relief të butë, përshkohet me lugina lumenjësh të vegjël, kryesisht dominon klimë e mesme kontinentale që karakterizohet me dimëra të ashpër, vera të thata me temperatura të larta e reshje të pakta, ndërsa ka një florë dhe faunë të pasur.

Në Komunën e Skënderajt banojnë mbi 50 mijë banorë ku 99% janë shqiptarë. Në strukturën e popullsisë kryesisht dominon moshja e re dhe atë: 47 % deri në moshën 20 vjeçare, 48 % nga 20-60 vjeçë, ndërsa vetem 5 % të moshuar mbi 60 vjeçë. Shtimi natyrorë ka një shkallë të lartë, mbi 28 promila me një shkallë të ulët të vdekshmërisë rreth 5 promila.

Komuna e Skënderajit si pozicion gjeografik gjendet në qendër të Kosovës, 50 km në veriperndim të kryeqytetit të Kosovës Prishtinës. Skënderaji si komunë është i përshirë në regjionin e Mitrovicës dhe është 20 km në juglindje të këtij qyteti.


Komuna e Skenderajit është në qendër të Kosovës dhe kufizohet me këto komuna të Kosovës:

- Në Veri me Mitrovicën
- Në Veriperëndim me Burimin (Istogun)

- Në Perëndim me Klinën
- Në Juglindje me Drenasin
- Dhe në Verilindje me Vushtrinë

Nëpër Komunë kalojnë disa rrugë me karakter të rrugëve nacionale si:

- Në pjesën veriore rruga Senderaj-Vushtri- Mitrovicë, e cila ka akse Lindje - Perëndim.
- Rruga Skënderaj- Drenas-Komoran -Prishtinë, ka aks Veri-Jug dhe është rrugë me karakter nacional
- Me karakter të rrugës regjionale është rruga Skënderaj - Klinë.
- Gjithashtu Skënderaji është i lidhur edhe me një rrugë të kategorisë së IV me qytetin e Vushtrrisë.



Lidhjet e Komunikacionit

Sa i përket infrastrukturës ekzistuese, infrastruktura rrugore është e ndërtuar, në afërsi jo të largët nga lokacioni kalon rruga magjistrale, Skenderaj-Prelovc -Vushtrri, afro 1600m , e lidhë lokacionin me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës.

KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE

Në komunën e Skënderajit si makroklimë mbizotëron klima kontinentale me verëra të nxehta dhe me dimëra shumë të ashpër dhe të ftohët. Meqënëse komuna ka një terren kodrinoro - malor me siguri ka edhe mikroklima të caktuara në pjesë të caktuara të territorit të saj, por në mungesë të një stacioni meteorologjik nuk ka të dhëna të sakta. Të dhënat për kushtet klimatike të komunës merren nga stacioni meteorologjik i Mitrovicës.

Temperatura mesatare vjetore është 10 shkallë Celzius

Muaji me i nxehtë është korriku dhe gushti me 20.4 0C

Muaji me i ftohtë është janari me – 1.3 4 0C

Maksimumi absolut arrihet në gusht me mbi 36.4 0C

Minimumi absolut arrihet në shkurt -25.24 0C.

Erërat dominante në Skenderaj kanë drejtimin e veriperëndimit. Erërat verore dhe pranverore fryejn nga jugu. Shpejtësitë mesatare më të mëdha të erërave janë:

Perëndimore 9.3 m/sec;

Verilindore 4.2 m/sec;

Veriperëndimore 3.8 m/sec;

Jugore 2.8 m/sec dhe

Lindore 1.6 m/sec.

Në komunë gjatë vitit të reshurat mesatare janë 604,8 mm

Vjetorja maksimale 850.9 mm (të reshura)

Vjetorja minimale 394.9 mm (të reshura)

Ditët më të hershme 5.11

Ditët më të vonshme 3.05

Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 71,4 %. Lagështia relative mesatare sipas stinëve në verë është 62,5 %, në pranverë 68,5 %, në vjeshtë 72,6 % dhe në dimër 81,6 %.

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

PËRKUFIZIMI I GURORËS

Përkufizimi i fushës së shfrytëzimit në VB në Prellovc është bërë në bazë të

- Vetive fiziko- mekanike
- Elementeve hapësinore të VB
- Topografisë së terrenit
- Shkallës së hulumtimit

duke respektuar këta faktorë, gjatë definimit të konturit të gurores fundi i gurores është përvetësuar në kuotën +790 dhe këto janë koordinatat e përcaktuara nga faza e hulumtimit

Kualiteti i gurit gëlqeror

Me qëllim të përcaktimit të kualitetit të gëlqerorëve nga ky VB, si dhe me qëllim të vlerësimit të aplikimit të tyre janë bërë analizat fiziko-mekanike, teknike si dhe kimike.

Nga analizat shohim se gëlqerorët e VB ka një gamë të gjerë të përdorimit ku në këtë rast konstatohet se mund të përdoren si:

- çakëll
- gur dekorativ
- ndërtim të trupit të rrugës
- tampon
- materialit për drenim në fraksione të ndryshme,
- si material i nevojshëm për hidroteknik (veshje të kanaleve, impiant, diga)
- material i copëtuar për muratim etj

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Nga investitori është paraparë që kapaciteti vjetor i gurores të jetë **80000** [m³ /vit] **fk**. Sipas detyrës projektuese nevojat për fraksione të formacioneve shkëmbore të separuar me këtë projekt do të jetë: nga të dhënat e prezantuara më lartë, shtrohet nevoja e llogaritjes së kapaciteteve prodhuese të shkëmbive duke marrë parasysh humbjet. Investitori në detyrën Projektuese ka paraparë kapacitetin vjetor të shkëmbive të jetë: $Q_{\text{vjet}}=80000 \text{ m}^3/\text{vit}$. Në përputhje me këtë është e

domosdoshme te merren parsyeshe humbjet eksploatabile te cilat mund te arrin deri ne 5%. ateher edhe prodhimtaria vjetore duhet te marre parasyesh dhe ne ket raste duhet planifikuar rritjen e prodhimtaries:

$$Q_{Vjet+EKSPL.Humb} = 80\,000 \cdot 100 / (100 - 5) = 84210 \text{ m}^3/\text{vit.}$$

$$Q_{HUMB\ EKSPL.} = 84210 - 80\,000 = 4210 \text{ m}^3/\text{vit.}$$

Per realizimin e prodhimtaries vjetore te gurit gelqeror duhet parapare edhe 5% materjal steril, ne ket raste koeficijenti i shfrytezimit merret(0,95), prandaj rezervat e shfrytezueshme vjetore:

$$Q_{Eksplo} = 84210 \cdot 100 / (100 - 5) = 88600 \text{ m}^3/\text{vit.}$$

$$Q_{STER} = 88600 - 84210 = 4390 \text{ m}^3/\text{vit.}$$

Sipas vlerave te fituara mund te percaktojm perqindjen e humbjeve dhe asaj te shfrytezimit te gelqerorve ne shkalle vjetore:

$$Q_{vit} = 80000 / 88600 = 0.9 \text{ (90\% nga sasia e tersishme)}$$

$$Q_{HUMB.EKSP.} = 4210 / 84210 = 0.049 \text{ (4.9\% nga sasia e tersishme)}$$

$$Q_{STERIL} = 4390 / 88600 = 0.05 \text{ (5\% nga sasia e tersishme)}$$

Per realizimin e kësaj prodhimtarie te nevojshme duhet te plotësohen këto kushte teknike:

-numri i ditëve te punues (12X21)	252 dit
-numri i ndërrimeve	
I,II,III,IV,IX,X,XI dhe XII muaji	1 ndërrim
V,VI,VII dhe VIII muaji	2 ndërrim
Gjithsejte (8X21)+(4X1.5X21)	294 ndërrime

Puna me ndërrime është e nevojshme te zërthehet ne kohen për punët ndihmëse dhe punët përgatitore. sipas treguesve real dhe praktikës se deri me tani ne këtë gurore koha efektive për një ndërrim merret 7[h] ose koeficienti i shfrytëzimit kohore është

$$k_i = (8-1)/8 = 0.875$$

Tab.2.6 Kapacitetet prodhuese

Nr	Njësia kohore	Kapaciteti		
		[m ³] mk	[m ³] msh	[t]
1	Kapaciteti orarë	45	58.5	72.09
2	Dit me një ndërrim	315	410	505
3	Dit me një ndërrim e gjysme	472	614	750
4	8 muaj (168 dit 1 ndërrim)	52920	68796	84143
5	4 muaj(84 dit 1.5 ndërrim)	39648	51542	63063
6	Viti	92568	119948	147075

d) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së ndërtimit dhe operimit

. Ndërtimi gjeologjik lokacionit

NDERIMI GJEOLOGJIK I RAJONIT TE GJERË

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit të Prellovc s Skenderaj marrin pjesë:

- Peridotitet
- Serpentinitet
- Rrepshet e palezoikut dhe
- Sedimentet e pliocenit.

PERIDOTITET DHE SERPENTINITET

Rrepshet Palezoike: Rrepshet palezoike I përkasin serisë së Veleshit siç janë: Rrepshet biotitike, Albitit-gnajse, Amfibolike sericitike-klorititike, Filite, Argjilet të metamofirzuara, Ranore metamorfik, Konglomerate kuarcore dhe mermeret.

Në disa zona janë të vertetuara rrepshet liskuitor.

Rrepshet janë të mbuluara me argjilë të kuqe në të verdhë.

Sempertinti: Këta shkëmbinjë ndërtojnë bazën e terrenit të hulumtuar si shkëmbinjë nikel bartës dhe të magnezit. Prezenca e këtij është e gjërë në rajon. Nga produktet e permoriasikut dhe kretakut në jug janë të zhvilluara strukturat tektonike me shtrirje lindje-perendim, derisa në perendim-lindje janë të ndërthurëra dislokacionet me drejtim të përgjithshëm veri-jug. Pjesa më e madhe e këtyre produkteve janë të mbuluara me sedimente të pliocenit dhe kuaternarit. Për dallim nga masivi peridotik I Dobroshevcit, këtu nuk hasim harburgite të freskëta. Në tërë rajonin takohen gjurmë të korës së prishur dhe erozionit që kanë ndikuar në krijimin e vndburimit të Ni-Co në serpentinitin e shpërbër.

Serpentina kryesisht është rreshpezuar dhe me shumë ndryshime. Kryesisht ndërtohet nga rrjeti I serpenitit, Antigoritit dhe Hrizotilit, me shumë pak prezencë të magnezitit sekondar. Gjithëashtu si process ne serpentite takohet edhe karbonatizimi dhe silifikimi që në disa raste është shumë I shprehur që ka me disa raste serpentinite të transformohet shkëmbi magneziti me relikte të kromit dhe materialit të sulfit.

Në kuadër të ndërtimit të strukturës së masivit të serpentinitit hyjnë edhe partitë opalizume që ndodhen në strukturat e thyera në drejtim veri-jug. Janë shkëmbinjë të forte me ngjyrë të kuqe. Në ndërtim marrin pjesë: Kalcedon, opal, oksid dhe hidroksid hekuri. Seria e konglomerate të metamorfizuar, ranoret dhe gëlqeroret-

Në pjesë periferike të masivit serpentinitik është zhvilluar kjo seri, që për nga pozicioni stratigrafik është një problem ende I pa definuar. Në terren është konstatuar konglomerate kuprite, kuarcit ranor flefeshpatik, argjilor argjilohiste dhe gëlqeror të prekrystalizuar. Vjetërsia e këtyre formacioneve është e pa definuar. Këta shkëmbinjë ende kanë karakteristikat e një sedimenti por në anën tjetër kanë shkallë të lartë të metamorfizmit. Në zonën e shkëmbinjëve të metamorfizuar janë të konstatuar këta anëtar litologjik:

- Kuarцитet kokërrimët
- Kuarцитet kokërrtrash
- Gëlqeroret e prekrystalizuara
- Rrepsheet kloritike-sericitike-albite.

Rrepsheet kloritike-sericitike: albite janë me ngjyrë të gjelbërt me strukturë lepidoblastike. Është ndërtuar nga kuarci kokërrimë. Kloriti dhe liskuni janë më rrallë të përfaqësuar në formë të

thierrzave të vogla dhe ndërfitjeve si shtresa të holla. Rrepeshet skundre të albit janë pjesërisht të përfshira nga procesi I kabnatizimit, kalciti sekondar shfaqet në formë damarore.

TRIASIKU I MESËM (T₂)

Në masivin e Qyqavicës dhe në grykën e Drenicës janë të zbuluar interkalicionet kuarcite, gëlqeror kristalor, vullkanike metamorfike. Gjetja e faunës marine kanë mundësuar përcaktimin e kohës së krijimit të tyre.

Triasiku u mesëm në rajonin e Baksit e sidomos në zonën e Qyqevicë janë të përfaqësuar nga ranorën metamorfik, argjilofilitet, meta stalloret, dollomitet e silifikuara, gëlqerorët kristalorë dhe keratofiret... Në shumë vende janë zbuluar mikro fauna detare: Glomospira friedli, Agathamaia australapina, Amoamobuculutes Sp. Gondollela.

SEDIMENTET E KRETAKUT

Seria e sedimeteve të kretakut të sipërm ka një shtrirje të gjërë në këtë rajon në drejtim të Prellovcit dhe në perëndim shkon në drejtim të Verbovcit. Kjo seri është vërtetuar në bazë të të dhënave faunistike dhe subpozicionit të shtresave senon dhe turon.

Turon (K₂²): Gëlqerorët e turonit shfaqen në formë të ishujve që kanë dimensione të ndryshme në neogjen të Drenicës, dhe njëkohësisht paraqitet si paleorelef I fazes paraliqenore tparaliqenore të basenit.

Janë të zhvilluar faciet gëlqerore të tipit dalmatin-istrik.

E rëndësishme është të theksohet se gëlqeroret e turonit shtrihen në formë transgressive në raport me serpentine. Trashësia e sedimeteve të turonit sillet deri në 150m. Shfaqja në profil të hapur vërehet në daljet e Verbovcit. Seria bazaltike fillon me konglomerate. Koglomeratet bazaltike kanë një trashësi deri në 50m, dhe gradualisht kalon në gëlqeror.

Në gëlqeroret me fosile spruodik janë Chondronte, Nerine, Toucasie, Radiolies dhe forma të tjera më pak prezente.

Në veri-lindje të Verbovcit në bazën gëlqerore përmes serpentineve, janë sedimentet që vërehet shfaqja e hekurit oolitik.

Senon K₃²: Sedimentet e senonit në kufinjë të hulumtimit është përkufizuar vetëm në formëv të një shiriti të ngushtë në pjesen anësore të masivit të Qyqavicës, paraqet vazhdimin e natyrshëm të

series snoniane. nsnoniane. Në përbërje të produkteve senoniane hyjnë: Konglomerati bazaltike, Gëlqeror masiv, Ranor argjilor, Argjilor, Argjilor, Ranor dhe Argjila mergelor.

Ranoret Kuarcor: në zonën e Baksit kanë një shtrirje të konsiderueshme, përshkrimi makroskopik: kanë ngjyrë të kuqe, kokërr të trashë në formë konglomerati. Këta janë ranor të ndërtuar nga fragmente me madhësi mesatare (0.7-20mm).

Shkëmbinjët karbonatik: kjo seri e shkëmbinjëve paraqet gëlqerorët organogjen me kallkernit. Janë të veçuara gëlqerorët e bardhë, ngjyrë hiri dhe gëlqerorët mergelore.

Gëlqeroret e bardhë: janë të ndërtuar me agregatet e kalcitit që ka në vete shpesh kalcit të pastër me shkëlqim. I ka të ruajtur mbetjet e : ehinodromat, me mekushace, alge, orbitolina. Mosha është kretaku I sipërm. Gëlqerorët ngjyrë hiri janë kokerë që janë krijuar në ujrat të cekëta, të cilat ndërtohen nga agregatet e kalcitit me mbetje të mikroorganizmave. Vërehen edhe formacionet e rudistëve dhe formanifereve. Kalciti është kokëtrash me shkëlqim.

SERIA E PLIOCENIT

Sedimentet e Pliocenit I takojnë basentit të Drenicës që kanë shtrirje në: Gllanasellë, Godanc, Likoshan dhe Baks. Seria e pliocenit është zona tavanore e serisë së kretakut dhe permotriasikut. Sedimentet e pliocenit janë të përfaqësuara nga: Argjila, Ranorët e më rrallë konglomerate të gëlqerorëve. Ka një trashësi të kufizuar dhe shumë rrallë deri në 30m. Në kuadër të serisë gjat hulumtimeve të Ni-Co dhe qymyri janë përcaktuar si antarët litologjik që e ndërtojnë këtë seri:

- Ranorët dhe Zhavori kuarcor.
- Seria argjilore dhe qymyrore.
- Shtresa qymyrore.
- Seria Dyshemore përbëhet nga argjila qymyrore-ranore, zhavori dhe argjila.
- Seria e hekurit politik.
- Xehja e Ni-Co.
- Serpentiniti.

Seria e neogjenit është kryesisht nga produktet argjilore me fragmente të rralla të karbonateve, që në mënyrë graduale kalojnë në argjilë ranore. Në disa lokalitete në periferi të produkteve të pliocenit dhe të kretakut të sipërm vërehet shtrirja treansgresive argjilesë mergelore me konkrcione karbonatike. Sedimentet e pliocenit janë vazhdim I pliocenit të basentit të Drenicës dhe që kanë shtrirje të kufizuar në zonën e kërkimeve.

TEKTONIKA

Tektonika e zones së gjërë është e lidhur me zhvillimet tektonike të basentit të Drenicës. Masivi I Dobroshevcit-Baksit I përket zonës së Vardarit. Janë të vërenjtura dy grupe të zonave të qarjeve. Grupi I parë shtrihet në anën perendimore të masivit. Për shkak të erozionit intensiv janë zbuluar në shumë vende formacionet e triasikut, ultramafitet dhe produkte të kretakut. Deformimet tektonike më të reja se ploceni I poshtëm nuk janë të vërejtura.

HULUMTIMET EKRYERA

Kompania “ERTI ”Shpk në zonen e licences së shfrytëzimit 2127/KPMM/20 janë kryer hulumtimet si dhe janë realizuar dhjetra minime .

Procesi teknologjik i shfrytëzimit dhe përpunimit të gurit gëlqeror

Përshkrimi i teknologjisë të shfrytëzimit të gurit gëlqeror

Për të shfrytëzuar gurin gëlqeror duhet të kryhen këto procese teknologjike: duhet bër largimin e shtresës së dheut (sterilit), shpim, minim, ngarkim dhe transport . Për realizimin e procesit teknologjik për shfrytëzimin e gurit gëlqeror nevojiten këto pajime: Garnitura për shpim, një ekskavator, një bulduzher, një lopatë ngarkuese dhe dy deri tre kamionë special për bartjen e shkëmbit të minuar gjerë te gurthyesi me seperacion.

Punimet e shfrytëzimit të gëlqerorëve në këtë vendburim do të zhvillohen sipas projektit kryesor të Xehetarisë ku janë përcaktuar të gjithë parametrat tekniko-teknologjik për shfrytëzim.

Në bazë të përvojës gjatë punës në kushte të njëjta dhe duke marrë për bazë karakteristikat e shkëmbinjve gëlqerorë në vendburim janë përcaktuar parametrat kryesor për hapje të karrierës:

- lartësia e shkallëve do te jetë 10m.
- gjerësia e sheshit të shkallës është 10-15m.
- pjerrtësia punuese e shkallës është 70 gradë.
- Shfrytëzimi i gurit gëlqeror do të kryhet përmes 3 shkallëve.
- sterili dhe materiali humesor nëpër rrugë të projektuara do të bartët dhe deponohet ne deponin e caktuar enkas për te e pastaj do të deponohet në sipërfaqen e shfrytëzuar.
- karakteristikat hidrogeologjike janë të volitshme nga aspekti i shfrytëzimit sepse ujërat atmosferik me punime minerare lehtë largohen nga karriera

- hapja e karrierës bëhet duke u nisur nga kuota fillestare e vendburimit nga lartësia në nivelin e kuotës +855m dhe nga thellësia në nivelin e kuotës të shkallës +790 m, me disnivel prej 65 m.

Ky proces bëhet në faza të cilat u cekën më lartë .

Etazhet zhvillohen në drejtim veri- jug, dhe atë në një kat bëhet shpimi dhe përgatitja e fushës për minim , kurse në katin (etazhin) më lart bëhet ngarkimi dhe transporti i masës së minuar më herët .

Minimi bëhet me eksplozive Amonali i përforcuar i cili është treguar efektiv në shfrytëzimin e gurit gëlqerorë.

Për të pas një pasqyrë reale të lëndëve plasëse në këtë raport të VNM-s do ti japim karakteristikat teknike të Amonalit të përforcuar.

Tipi i lëndes plasëse

1. Amonium nitrat.....-82+1.5%
2. Trinitro trotuol.....- 14 + 1%
3. Tallash druri.....- 4 + 0.5%

Karakteristikat

Dendësia	kg/l	1.1-1.15
Shpejtësia e detonimit	m/s	4400-4500
Përcjellja e detonimit	cm	4-9
Bilanci i oksigjenit	% peshore	4
Vëllimi i gazrave	L/kg	+0.24
Lirimi i nxehtësisë	⁰ C	2564
Presioni i deponimit	Dn/m ²	56619
Diametri i llokumit	Ø	60

Në rastin e minimit në gurin gëlqeror, është e kalkuluar largësia e gjuajtjes së copave shkëmbore, gjë që nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën. Konsumi specifik për një vrimë është llogaritur të jetë 30 kg e cila është 36 herë më e vogël se sasia e lejuar për shkallen e tretë të merkalisit ku shpejtësia e lejuar e oscilimeve të trupit është 0.4 deri në 0.8 cm/s.

Por tani me sistemin e ri të minimit, do të kemi sigurinë ma të madhe.

Nga kjo mundë të konstatojmë që veprimet sezmiologjike në objektet sipërfaqësore duke marrë parasysh distancën e larguar është i pranueshëm në procesin teknologjik. Rrezja e zonës së rrezikut caktohet në bazë të përdorimit të eksplozivit që aktivizohet:

$$R = 5 \sqrt[5]{Q} = 5 \sqrt[5]{2478} = 248,89 \approx 250 \text{ m}$$

R- zona jo e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit

Q- sasia e eksplozivit për një minim

5- koeficient i cili merret për distancën e palosjes së masës së shkëmbit (m)

Prandaj minimet në këtë lokalitet nuk paraqesin ndonjë rrezik për rrethinën sepse objektet banuese janë të larguara nga lokacioni mbi 500m, kurse zona e rrezikuar për njerëz dhe objekte nga copat e hedhura të shkëmbit është $\approx 250\text{m}$.

Nga minimi gjithmonë duhet të ketë kujdes që madhësia e shkëmbit të minuar të jetë në granullometri të lejuar për fytyrën e thërrmueseve primare, gabaritet e mëdhenj nuk guxojnë të jenë prezent më tepër se 20% nga madhësia e fytyrës pranues.

Përshkrimi i thërrmueses me seperacion dhe pajimeve përcjellëse

Pronarët e Kompanisë „Erti 2 ” për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror planifikojnë të blejnë pajimet të prodhuara nga kompania Ugur Makina nga Turqia të prodhuara në vitin 2017, të cilat do të i vendos në pjesën e ngastrës të lartshënuar:

Thërrmuesja me nofulla kapaciteti 80-100m³/h, thërrmuesja me nofulla, ka të bashkangjitur bunkerin pranues me vëllim prej 15m³, dozatorin me vibrim dhe transportuesit shiritor për bartje të materialit steril dhe atij të thërrmuar. Pronari i kompanisë planifikon të e blej seperacionin (sitën vibruese të pjerrtë) dimensionet e sitës do të jenë 1530x4800mm, kapaciteti i sitjes gjëhet në 100 m³/h, seperacioni (sita vibruese e pjerrtë) do të jetë, sitë një etazhore me mundsi për vendosjen edhe të dy rrjetave, transportuesit shiritor për transportimin materialit të seperuar, edhe një gurthyes sekondar (mullirin) me traj dhe një sitë vibruese me shirita transportues, para gurthyesit sekondar (mullirit) me traj do të ekzistoj shiriti transportues për sjelljen e fraksionit + 22 apo 32mm, pas gurthyesit sekondar (mullirit) me traj do të ekzistoj një shirit transportues për bartjen e materialit të thërrmuar në sitën vibruese, pastaj do të ekzistojnë edhe katër shirita transportues përmes të cilave materiali i seperuar transportohet në deponit adekuate, dhe një shirit transportues për kthimin e mbifraksionit +32 mm në gurthyes terciar (mullirit) me traj për tu rithërrmuar e pastaj përmes shiritit transportues materiali i thërrmuar hedhet në shiritin transportues i cili e bartë materialin e thërrmuar nga thërrmuesja sekondare në sitën vibruese. Me këto pajime ekzistuese mund të prodhohen fraksionet si që janë +0-2 mm, +2-4 mm, +4-8 mm, +8-16 mm, +16-22 mm +16-32 mm dhe +32mm, për tampon për agregat betoni, agregat asfalti dhe elemente të betonit (kubzat dhe gypat e betonit), etj.

Procesi teknologjik i gurëthyesit me seperacion

Prodhimi në gurëthyes me seperacion bëhet në bazë të kërkesave për fraksione të blerësve, në bazë të cilave bëhet edhe plani i biznesit të Kompanisë. Prodhimi në gurëthyes me seperacion bazohet në prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, e fraksioneve për agregat betoni, agregat asfalti dhe elementeve të betonit (kubëzat dhe gypat e betonit). Në vijim po japim përshkrimin e procesit teknologjik komplet të gurthyesit me seperacion për prodhimin e fraksioneve për ndërtimin e rrugëve, për agregat betoni, agregat asfalti dhe elementeve të betonit (kubëzat dhe gypat e betonit).

Guri gëlqeror nga kamionët derdhet në bunkerin pranues të gurëthyesit ose nga deponia me anë të lopatës ngarkuese derdhet në bunkerin (furtinën) pranuese shënuar me nr. 1, të gurëthyesit të cilin ne kemi dhënë në vizatim (shema teknologjike), mandej me anë të dhënësit vibrues nr. 2, ushqehet thërrmuesja primare me nofulla nr. 3, transportuesi shiritor nr. 2a është i dedikuar të bart materialin steril që ndahet nga guri gëlqeror përmes vrimave që janë të vendosura ne dhënësin vibrues, në këtë mënyrë bënë pastrimin e gurit gëlqeror që do të trajtohet në gurëthyesin me seperacion dhe të përgatis prodhimin për aplikim sa ma të mirë në ndërtimtari të ulët dhe të lart, nga thërrmuesja primare me nofulla nr. 3, guri gëlqeror me transportues shiritor nr. 4, transportohet në siten vibruese nr. 5 , nga ku fraksioni 0-32mm përmes transportierit shiritor nr.6 dërgohet në deponin adekuate, kurse fraksioni + 32mm përmes transportierit shiritor nr.7 dërgohet ne thërrmuesen sekondare me traj (mullirin) nr. 8, materiali i thërrmuar përmes transportierit shiritor nr.9 dërgohet ne sitën vibruese nr.10, nga sita vibruese përmes shiritave transportues nr. 11, nr. 12, nr. 13, dhe nr. 14, transportohen fraksionet e prodhuara +0-4 mm, +4-8 mm, +8-16 mm, +16-22 (32) mm ne deponit adekuate për kto fraksione, kurse përmes shiritit transportues nr. 9a, fraksioni mbi 22 (32)mm kthehet ne thërrmuesen terciare me traj (mullirin) nr. 8a, për tu thërrmuar prapë, materiali i thërrmuar përmes shiritit transportues nr. 9b dergohet në shiritin transportues nr. 9 përmes të cilit dërgohet ne sitën vibruese nr.10. Në sitë sigurisht se mbetet një sasi e cila kalon kufijtë e të kërkuarës (do me than se madhësia e një pjese të kokrrave të fraksionit është më e madhe se vrimat e sitës), prandaj këjo sasi e materialit do të kthehet përsëri me anë të transportuesit shiritor nr 9a, në thërrmuesen terciare numër 8a, ku do të thërrmohet në madhësi të fraksioneve të lejuara, dhe kështu e përgatitur sbashku me materialin tjetër me transportier shiritor nr. 9b dhe 9, kthehet në sitën vibruese nr. 10, për trajtim të dytë, e po qe se ka nevojë (ajo në

mënyrë kontinuale) do të kthehet edhe herave tjera në thërrmuesen terciare gjerë sa të fitohet madhësia e fraksioneve që do të kalojnë nëpër rrjeta të sitës.

Menaxhimi i procesit teknologjik bëhet nga dhoma e cila duhet ndërtuar afër gurthyesit e në të cilën do të vendosen ormani me tërë automatiken dhe mbrojtësit për tërë hargjuesit e energjisë elektrike, si dhe pulti komandues i cili është i vendosur në ormanin adekuat të caktuar për te.

Automatika do të rregullohet në atë mënyrë që mundëson lëshuarjen në punë të pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike dhe manuale. Në pultin komandues do të ekzistojnë rregullatori komandues për zgjedhjen e punës së gurthyesit me seperacion. Nëse zgjedhim punën automatike, atëherë për fillimin e startimit të pajimeve të gurthyesit me seperacion, pajimet lëshohen në punë automatikisht, duke filluar nga më të largëtat kah të afërmet, nga transportierët për fraksion finale, pasandaj sita vibruese, transportieri shiritor, gurthyesin sekondar dhe sekondar, transportierët shiritor tjerë, sita vibruese, transportierët shiritor, thërrmuesen primare me nofulla, transportieri shiritor dhe në fund dozuesin vibrues.

Te ndalesa e pajimeve të gurthyesit me seperacion në mënyrë automatike, pajimet ndalen me radhë në anën e kundërt të lëshimit të pajimeve duke filluar nga dozuesi vibrues e tutje. Të zgjedhja e punës në mënyrë manuale, pajimet lëshohen në punë secila në vete, përmes tastereve të veçanta, sipas zgjedhjes ton, gjithashtu edhe te komanda manuele duhet respektuar radhën, e lëshimit të pajimeve në punë, sikurse të mënyra automatike. Udhëheqja manuele preferohet vetëm në raste të defekteve, dhe në raste të remontit të pajimeve. Në këtë mënyrë, me anë të këtyre proceseve teknologjike në gurëthyesin me seperacion mund të prodhojmë këto fraksione nga guri gëlqeror: fraksione për tampon të rrugëve, fraksione për beton dhe fraksione për prodhim të asfaltit të cilat do të i paraqesim më poshtë. Fraksionet e tamponit të rrugëve 0 - 32 mm, 0 - 63 mm dhe 0 - 100mm


Fraksione e Betonit 0 - 4 mm, 4 - 8 mm, 8 - 16 mm, 16 - 22 ose 32 mm

Fraksionet e asfaltit 0-2 mm, 2- 5 mm, 5-8 mm, 8 - 11 mm, 11 - 16 mm, 16-22 mm

Pajimet në gurëthyes me seperacion aktivizohen me anë të energjisë elektrike ku pronari do të bëjë ndërtimin e trafos dhe të rrjetit elektrik me mjete personale. Por për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të energjisë elektrike investitori do të pajiset edhe me një gjenerator për aktivizimin e pajimeve teknologjike, gjithashtu në këte lokacion pronari planifikon të e ndërtoj ofiçinën për mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese si dhe pajimeve prodhuese. Përveç pajimeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin gurit gëlqeror

dhe shërbimeve tjera kompania do të disponoj mekanizëm ngarkues dhe transportues si.psh. dy lopata ngarkuese, një ekskavator, gjashtë kamionë etj. Ndërtesën për personelin e kompanisë dhe mbajtjen e pjesëve rezervëRenditja dhe lidhshmëria e pajimeve dhe stabilimenteve në mes veti të cilat nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror të cilat do të blihen dhe vendosen në pjesën e ngastrës së lartë cekur shihet në shemën teknologjike në vijim.

Shema Teknologjike e gurtlyesit
me seperacion



Legjenda

- 1. bunkeni pranes;
- 2a. shiriti transportues;
- 2. dozuesi vjornes;
- 3. gurtlyesi me notulla;
- 4. shiriti transportues;
- 5. sifa vjornese;
- 6,7. shiritat transportues;
- 8, 8a, gurtlyesi me traj;
- 9,9a, 9b, shiritat transportues;
- 10. sifa vjornese;
- 11,12,13,14. shiritat transportues;

2. Baza ligjore për hartimin e raportit

Raporti i VNM-së përfshin identifikimet që rrezikojnë mjedisin, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe propozimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental gjatë realizimit të aktiviteteve minerare për shfytëzimin e gurit gëlqeror në lokalitetin Seqishtë dhe atë :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjer në kufijtë e lejuar.

2.1 Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat evropiane të mbrojtjes së tij ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit daton në vitin 2003, tani i hartuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, ndër të tjera në të potencohet se të gjitha veprimtaritë e personave fizikë dhe ligjor, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari të reja dhe kanë ndikime të theksuara negative në mjedis, do të jenë temë e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 ka për qëllim që të sigurojë mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

- Ligjet me të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin për eksploatimin e gurit gëlqeror janë si më poshtë: Ligji për VNM Nr.08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për minierat dhe mineralet Nr. 03/L-163
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për minierat dhe mineralet
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes Nr .03 / L-043
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174

- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 2003/3 për Pyjet e Kosovës Nr. 03/L-153
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për Mbeturina Nr 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-060 për mbeturina
- Udhëzim administrativ (qrk) - nr. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzim administrativ (qrk) nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave
- Udhëzim administrativ mmph - nr. 10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale
- udhëzim administrativ nr. 13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave
- Udhëzim administrativ (qrk) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Ligji për mbrojtjen e ujërave Nr. 04/ L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Udhëzimi Administrativ Nr 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis duhet marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve, gjatë fazës së realizimit të veprimtarive punuese për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare, dhe pas përfundimit të projektit, për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare, ndikimet në mjedis gjatë fazës së përgatitjes së fushës për fillimin e punëve për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerare, nuk do të analizohen se në kohën e kryerjes së raportit ka qenë duke u eksploatuar guri gëlqeror, në këto lokalitete dhe nga e njëjta kompani, prandaj në pjesën e kësaj ngaste kompania në fjalë donë të e bëjë zgjerimin e fushës eksploatuese.

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos vizitave që iu janë bërë lokalitetit disa herë, konsultimeve që janë bërë me pronarin dhe ekspertët që janë duke e udhëhequr procesin teknologjik për eksploatimin e gurit gëlqeror me aktivitetet tjera minerar, gjithashtu janë shfrytëzuar edhe:

- Elaborati gjeologjik për vendburimin e lartcekur

- Projekti kryesor për eksploatimin e gurit gëlqeror
- Çertifikata e biznesit
- Çertifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme
- Kopja e planit të ngastrës
- Pëlqimi nga kuvendi komunal të Skenderajs

Krahas parashikimeve themelore nga rregullivat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hulumtimit për rastin konkret janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke u nis nga fakti se një pjesë e madhe e mardhënjeve specifike nga lëmia e mjedisit nuk është përfshirë në rregullivat e tanishme prandaj për nevoja të këtij punimi është shfrytëzuar përvoja e mirë dhe rregullat relevante ndërkombëtare, si dhe direktivat përkatëse.

3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Shfrytëzimi seperimi dhe perpunimi i gurit gëlqeror dhe kryerja e aktiviteteve tjera minerare ku është planifikuar të bëhet zgjerimi i fushës eksplatare e që kompanija ka licencë në pjesët e ngastrave kadastrale nr. **P-72015058-00313-0** dhe **P-72015058-00314-1** , **P-72015058-00314-2** Çertifikatën nr. 48287/25 dt 10.11.2025 zona kadastrale Prellovc , komuna Skenderaj , pronë e blerë nga kompanija “Erti 2”LLC Skenderaj me pronar Florim Bucollin m e sip 70,470 .00 m2.

Pronari I kompanisë dhe Stafi I saj kanë punuar një kohë të gjatë në këtë veprimtari dhe është I interesuar që përvojen e ushtruar në këtë fushë deri më tani ta implementoj dhe përfeksionoj në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të gëlqërorëve veçanti dhe resurseve minerale në përgjithësi për nevojat e industrisë së ndëritimit në Kosovë. Për këtë arsye prej disa viteve është duke bërë përpjekje që të investoj në zhvillimin dhe n zgjerimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e lëndëve të para në industrinë e ndëritimit, me një teknologji të avancuar, e cila ka si kriter kryesor ka mbrojtjen e mjedisit jetësor ku zhvillohen këto aktivitete.

Përzgjedhja e keti VB ne Prellovc te komunes se Skenderaj do të përfshijë këto tërësi tematike:

- Të dhënat e përgjithshme mbi vendburimin
- Nevojat ne rritje për fraksione
- Llogaritja e rezervave
- Vlerësimi I Vendburimit

4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Rajoni i gjerë i Mihjes Sipërfaqësore e kompanisë Erti 2 karakterizohet me një relief kodrinorë –malore që kufizohet me vargmalet e grykës së Prellovc s me lartësi mbidetare nga 770m në luginën e deri 900m

Brenda zonës së hulumtimeve, mjedisi është i pa degraduar, por zonat përreth janë të hulumtuara dhe shfrytëzohen nga operatorët tjerë të licencuar

Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë e mesme kontinentale.

Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillen prej 9-10.5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 10°C.

Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C.

Temperaturat më të ulta kanë qenë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore për vitet e hulumtuara janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej (-1,7)-(-3,4°C).

Regjimi i reshjeve në komunën e Skenderajës ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillen nga 520 mm deri në 706 mm (për vitet e hulumtuara).

Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 87.6%.

4.1. Hidrogeologjia

Terreni në të cilin është komuna e Skenderajt i takojnë slivit të Detit Adriatik. Në lindje të komunës rrjedh lumi Klina, rrjedha e majtë e Drinit të Bardhë. Në lindje dhe juglindje rrjedhin lumejtë Sitnica dhe Drenica.

Lumi “Klina” buron në fshatin Kuqicë dhe përshkon territorin në aksin veri jug dhe kalon nëpër tërë territorin e Komunës si dhe në qendrën e qytetit të Skënderjat me një rrjedhë të ngadalshme, me një thellësi mesatare dhe një gjatesi prej 40 km.

Gjithashtu nëpër territorin e komunës ka edhe një numër të madh përrockash të cilat në tërësi derdhen në lumin “Klina”. Rrjedhat e lumenjëve nuk i rrezikojnë vendbanimet sepse ato deri më tani nuk kanë dalur nga shtrati i tyre.

Në territorin e Komunës së Skënderajt nuk egziston asnjë liqen, as natyrorë por as edhe artificial përpos disa rezervateve të ujit të cilët edhe ata janë në numër të vogël

4.2. Ndryshimet natyrore

Rajoni i gjerë i Mihjes Sipërfaqësore e kompanisë Erti 2 karakterizohet me një relief kodrinorë –malorë që kufizohet me vargmalet e grykës së Prellovc me lartësi mbidetare nga 770m në deri 900m .

